



### MARREVESHJE SIGURUESE

Ne Tirane, sot me date 31.08.2018 (dy mije e 18-ti), para meje Noterit **JULIAN ZHELEGU**, Noter i Dhomës se Notereve Tirane u paraqiten personalisht:

- I. **z. Ervis Tashi**, lindur me 13.04.1984, vendlindja Lushnje, banues ne adresen: Rr.Ismail Qemali Pll Agimi 1 Ri Tirane me Leternjoftim Nr 024962928 dhe nr.personal I40413074J madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet **Barredhenes**);
- II. **"BANKA CREDINS" SH.A**, shoqeri shqiptare e regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr. 28969, Date 31.01.2003, regjistruar ne organin tativor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT Nr. K 316088010, si dhe me Licensen e Bankes se Shqiperise Nr.16, date 31.03.2003, e perfaqesuar nga Drejtor i Divizionit te Zhvillimit te Biznesit **z. Selman Lamaj**, lindur me 03.10.1965 me Leternjoftim Nr. 025074453 dhe Nr. personal G31003096V dhe nga Zv. Drejtore e Divizionit te Zhvillimit te Biznesit dhe Drejtore e Departamentit te Korporatave dhe Biznesit te Madh **z. Sofika Nazaj**, lindur me 12.11.1964 me Leternjoftim Nr. 024651589 dhe nr.personal G46112105Qe njojur personalisht para meje, madhere dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet "**Barremarres**").

Ne kete kontrate, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përbajtja e nenit. Termat në gjininë mashkullore nënkuqtojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

#### Neni 1 **Objekti i Kontrates**

1.1 Krijimi i një barre siguruese mbi pasurite e luajtshme te **Barredhenesit**, si garanci per shlyerjen e kredise se akorduar nga **Banka Credins** ne baze te **Kontrate Overdraftit Nr.6057, Nr.5718 Rep./Nr.1888 Kol., Date 20.07.2018** noterizuar nga **Noteri Julian Zhelegu**

1.2 **Barredhenesit** vendosi barre mbi kolateralin e pershkruar si me poshte:

- **100% te aksioneve dhe te drejtat qe lidhen me to qe z. Ervis Tashi zoteron ne shoqerine tregtare "IVAN OIL" sh.a., me NUIS L81920001S, me seli ne Rruga Lord Bajron, Hyrja -1, Tirane, si edhe mbi kuotat/aktionet e reja qe mund te zoteroje ne te ardhmen ne kete shoperi tregtare.**

#### Neni 2 **Baza Ligjore**

2.1 Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës se Shqiperise i ndryshuar.

#### Neni 3 **Vlefshmeria**

3.1 Marreveshja hyn ne fuqi diten e nenshkrimit nga palet dhe mbetet ne fuqi deri ne shlyerjen e plete te kredise se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera te parashikuara, ne kontraten e kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto.



**Neni 4  
Garancite**

4.1 Barredhenesi garanton dha siguron se eshte pronar legjitim dhe i vetem i kolateralit.

4.2 Barredhenesi garanton Barremarresin se kolaterali, eshte i lire nga cdo barre, detyrim, apo garanci tjeter.

**Neni 5  
Detyrimet e barrëdhënësits**

5.1 Gjatë kohëzgjatjes së kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, per garantimin e te cilave eshte lidhur kjo marreveshje siguruese, Barrëdhënësi është i detyruar te ruaje, te siguroje dhe te mos lejoje perkeqesimin e situates ligjore dhe financiare te kolateralit te blokuar ne favor te Barremarresit ne perputhje me kete marreveshje siguruese.

5.2 Barrëdhënësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo fakt dhe rrethanë që mund të rrezikojë/perkeqesoje situaten ligjore dhe financiare te kolateralit dhe ose ekzekutimin e tij.

5.3 Barredhenesi ka detyrimin per te njoftuar Banken per cdo konflikt gjyqesor dhe/ose administrativ ne lidhje me kolateralin objekt i kesaj marreveshje siguruese.

**Neni 6  
Kompletimi i barres siguruese**

6.1 Barra siguruese quhet e kompletuar me permbushjen e sa specifikuar ne Ligjin "Per barret siguruese" i ndryshuar.

6.2 Barredhenesit me ane te kesaj marreveshje autorizojne Barremarresin te nenshkruaje, kompletoje, regjistroje dhe depozitoje te gjitha dokumentet e nevojshme ne te gjithe registrat perkates te percaktuar nga ligji ku pasqyrohet bllokimi i kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguruese.

6.3 Barredhenesit do te paguajne shpenzimet per kompletimin, regjistrimin, depozitimin etj e te gjitha dokumenteve te nevojshme ne te gjithe registrat perkates te percaktuar nga ligji per efekt te bllokimit te kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguruese.

**Neni 7  
Detyrimet e siguruara**

7.1 Barredhenesit sigurojne me kolateralin:

- i) Pagimin e detyrit sipas kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto;
- ii) Kryerjen e te gjitha veprimeve ligjore qe burojne nga aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojn keto marredhenie;
- iii) Pagimin e shpenzimeve per ekzekutimin e kolateralit.

**Neni 8  
Ekzekutimi i barres siguruese**

8.1 Ne rastin kur Kredimarresi eshte ne vonese ne pagimin e kesteve mujore se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet, te parashikuara ne kontraten e kredise te specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, Bankes i lind e drejta per te dekluar si te kerkueshme per tu paguar te gjithe detyrimet e garantuara me Marreveshjen Siguruese, si dhe shpenzimet qe perfshijnë shpenzimet gjyqesore si dhe cdo shpenzim ligor deri ne ekzekutimin e plete te tyre, sipas procedurave te parashikuara ne Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar.

8.2 Barrëdhënësi, menjëherë pas marjes së njoftimit nga Banka, do të dorëzojë kolateralin me shpenzimet dhe në përgjegjësinë e tij në çdo vend te përcaktuar nga Banka, bashkë me dokumentet përkatëse. Në rast se Barrëdhënësi nuk e



përbush këtë detyrim, Banka do të vijoj me proceduren e ekzekutimit te parashikuar ne Ligjin "Per Barret Siguruese" i ndryshuar.

**Neni 9  
Verifikimi i kolateralit**

9.1 Barremarresi ose agjentet e tij kane te drejte te bejne inspektime dhe te verifikojne kolateralin ne cdo kohe dhe kohe pas kohe, dhe Barredhenesi eshte dakort qe te ofroje gjithe asistencen dhe informacionin e duhur mbi gjendjen ekzistuese apo kushtet dhe rrethanat qe ndikojne mbi te.

**Neni 10  
Ndalime qe kufizojne te drejtat qe lindin nga pronesia**

10.1 Barredhenesi nuk ka te drejte te ndryshoje apo te krijoje te drejta pronesie ose te drejta te tjera reale mbi kolateralin, ta perdore ate si kolateral per detyrime te tjera te tashme apo te ardhme, te tyre apo te te treteve pa marre me pare pelqimin me shkrim te Barremarresit.

10.2 Barrëdhënësi nuk ka të drejte të anulloje, transferojë, të tjetersojë apo disponoje, ne cfaredo forme, kolateralin e barrësuar apo të zvogëlojë vlerën e tij pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

**Neni 11  
Vazhdimesia e sigurimit te ekzekutimit te detyrimit**

11.1 Ne rast se kolaterali humbet, demtohet apo zhvleftesohet, si dhe kur Banka çmon se vlera e tij nuk mjafton apo eshte zvogeluar ne vlera, për të mbuluar detyrimin e siguruar nga kolaterali barremarresi ka te drejte te kerkoje shtimin e kolateralit si dhe garanci te plotë nga pasuri te tjera te barredhenesit, ndersa Barredhenesi ka detyrimin ta shtoje kolateralin me kerkesen me te pare te Barremarresit.

11.2 Kjo marreveshje siguruese është titull ekzekutiv.

**Neni 12  
Mosmarreveshjet**

12.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis paleve si rezultat i kesaj Kontrate zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 13  
Ndryshimet**

13.1 Shtesa, ndryshime nga kjo Marreveshje duhet te behen me shkrim dhe te nenshkuhen nga palet.

13.2 Kjo Marreveshje se bashku me shtesat apo ndryshimet e saj do te jene detyruese per barredhensin dhe trashegimtaret e tyre respektiv.

**Neni 14  
Njoftimi Zyrtar midis Paleve**

14.1 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve ne kete marreveshje, do te behen me shkrim te dorezuara personalisht ose me poste te regjistruar (rekomande) dhe/ose adresen e e-mail ne adresen e percaktuar ne kete marreveshje.

14.2 Barredhenesit deklarojne dhe pranojne qe te gjitha llojet e njoftimeve te bera ne adresat e deklaruara nga ana e tyre sipas kesaj marreveshje do te konsiderohen si te marra nga ai/ata.

14.3 Barredhenesit jane te detyruar qe te njoftojne menjehere çdo ndryshim ne adresen e tyre. Per sa kohe qe ata nuk kane njoftuar adresen e re, njoftimet do te quhen si te kryera dhe barredhenesit nuk kane te drejte dhe heqin dore nga cdo pretendim ne lidhje me njoftimet e bera ne adresen e deklaruar prej tyre sipas kesaj marreveshje.



Kjo Marreveshje Siguruese hartohet ne 5 (pesë) kopje me vlerë te barabarte, dhe pasi lexohet dhe gjendet konform vullnetit te lire e te plotë te paleve nenshkruehet si me poshtë. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.


**PALET KONTRAKTUESE**

**BARREMARRES**

**"BANKA CREDINS" SH.A**

Drejtori i Divisionit te Zhvillimit te Biznesit te Madh

Selman LAMAJ



Zv. Drejtore e Divisionit te Zhvillimit te Biznesit te Madh


Drejtore e Departamentit te Biznesit te Madh

Sofika NAZAJ



**BARREDHENES**

**Ervis TASHI**



**NOTER**

**JULIAN ZHELEGU**

